



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE
KOMISIONI PËR ORGANIZIMIN DHE PËRGATITJEN E DOKUMENTAVE PËR SPORTIN
PUBLICITAR, REKLAMËN NË TV, FUSHATËN PUBLICITARE NË MEDIA ONLINE, PËRCAKTIMIN E
FONDIT LIMIT SI DHE VLERËSIMIN E OFERTAVE

Nr. 608 / Prot
72

Tiranë, më 21 / 10 / 2024

FTESË

Për: Organeve të masmedias / Agjencive të Specializuara

Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, në mbështetje të VKM nr.1195 datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radioteleviziv ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore” dhe në Ligjin nr. 9947, dt.07.07.2008, “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar, do të realizojë procedurën për organizimin e fushatës publicitare dhe prodhimin e spotit televiziv.

Objekti :

Transmetim i spotit në 2 televizione të ndryshme kombëtare (24 spote/6 ditë, jo më pak se 4 transmetime në ditë në 2 televizione);

Prodhimi i një spoti TV, sipas kërkesave të institucionit;

Nevoja për kryerjen e fushatës :

Nevoja e kryerjes së fushatës, është për shkak se Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale në bazë të pikës 1, të nenit 189 të ligjit 9947, datë 07.07.2008 « Për Pronësinë Industriale », i ndryshuar, ka detyrë regjistrimin, administrimin dhe promovimin e objekteve të PI-së.

Ju lutemi kërkojmë të na vini në dispozicion të ofertës tuaj për shërbimin e kërkuar sipas specifikimeve si dhe përcaktimeve në tabelën e mëposhtme:



Bulevardi “Zhan D’Ark”, Prona nr.33, Shtëpia e Ushtrakeve, Tiranë, Shqipëri(AL)
Web Site: www.dppi.gov.al E-mail: info.dppi@dppi.gov.al

Nr	Përshkrimi i shërbimeve	Sasia	Cmimi /njësi	Cmimi /Total	AFATI
	TRANSMETIMET				
1.	<i>Transmetim i spotit në 2 televizione të ndryshme kombëtare</i>	<i>(24 spote/6 ditë, jo më pak se 4 transmetime në ditë në 2 televizione)</i>			01-07 Nëntor 2024
2.	<i>Prodhiimi i një spoti TV, sipas kërkesave të institucionit</i>	1			
	TVSH(%)				
	Çmimi TOTAL				

Fondi Limit është 1 330 000 (një milion e treqind e tridhjetë mijë) lekë pa TVSH.

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të deklarojë:

a) Të jetë i regjistruar pranë Administratës tatimore me status aktiv.

- Të mos jetë në proces falimentimi.
- Të mos ketë detyrime tatimore të papaguara përfshirë detyrime të sigurimeve shëndetësore & shoqërore.
- Të mos jetë i dënuar me vendim Gjykatë të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional.
- Të mos jetë i dënuar për shkelje penale në përputhje me nenin 76 të Ligjit 162/2020 për Prokurimin Publik.
- Fusha e veprimtarisë të jetë në përputhje me kërkesat e paraqitura në këtë “Ftesë për negociatë”.
- Shërbimet të realizuara të së njëjtës natyrë, të vërtetuara me faturë tatimore.
- Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik, që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Mosplotësimi i kriterëve të mësipërme përbën kusht për skualifikimin e ofertuesit.



Bulevardi “Zhan D’Ark”, Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë, Shqipëri(AL)

Web Site: www.dppli.gov.al E-mail: info.dppli@dppli.gov.al

Dokumentat që vërtetojnë plotësimin e kriterëve, të siguruar jo më parë se 3 muaj nga dita e hapjes së ofertës duhet të paraqiten në formë origjinale ose kopje të noterizuara.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kriteret (pikat 1-3) duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Kushte specifike

1. *Transmetim i spotit në 2 televizione të ndryshme kombëtare, në datat 01-07 Nëntor 2024 në fashat orare 07:00-09:00 dhe 15:00-22:00;*
2. *Prodhim 1 spoti TV, sipas kërkesave dhe miratimit final nga DPPI;*
3. *Buxheti të paraqitet i vecantë dhe i detajuar për të gjithë zërat, bazuar në formularin e një media plani të paraqitur nga ofertuesi;*
4. *Në përfundim të realizimit të procedurës, operatori ekonomik do të paraqesë pranë DPPI raportin e monitorimit.*

Më shumë informacion mund të gjeni në Faqen e DPPI-së, me adresë www.dppi.gov.al

Për informacione të mëtejshme ose për paqartësi ju lutem kontaktoni në adresën e kontaktit:

nr.tel: +3552234412

e-mail: perparim.mezini@dppi.gov.al

Kjo procedurë do të kryhet mbi bazën e VKM-se Nr.1195, datë 05/08/2008 “Për blerjen zhvillimin, prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radioteleveizive ose botim në medianë e shkruar dhe për kontrata, për kohë transmetimi, nga organet e Administratës Shtetërore”

Çdo organ i masmedias /Agjensi e specializuar ftohet të dorëzojë ofertë. Kontrata do të akordohet atij organi që ka dorëzuar ofertën e vlerësuar si më e mira, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë dokumentacion dhe në bazë të VKM nr.1195 dt.05/08/2008, neni 7.(A.Organi i masmedias së ofruar 15 pikë, B. Cmimi i ofruar 70 pika C. koha e transmetimit 15 pikë)

Organet e masmedias agjensi të specializuar duhet të dorëzojnë ofertën origjinale si dhe dokumentacioni i kërkuar më sipër(kërkesat e përgjithshme) të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e ofertuesit dhe të shënuar ofertë për kryerjen e shërbimit.

Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni dhe jo para datës 28/10/2024, ora 11.00.

Oferta ekonomike duhet të paraqitet sipas formularit të mësipërm, ku të specifikohen saktësisht nga operatori ekonomik ofertues se cilat janë, mediat ku do të transmetohet spoti, pozicioni ku do të transmetohet spoti në Ledwall, mediat online ku do të publikohet shkrimi promociional.



Bulevardi “Zhan D’Ark”, Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë, Shqipëri(AL)

Web Site: www.dppi.gov.al E-mail: info.dppi@dppi.gov.al

Afati kohor për dorëzimin e ofertave, si dhe për zhvillimin e negocimit në lidhje me procedurën me objekt “ *Transmetim i spotit në 2 televizione të ndryshme kombëtare (24 spote/6 ditë, jo më pak se 4 transmetime në ditë në 2 televizione)*;

*Prodhim 1 spoti TV, sipas kërkesave të institucionit; është me datë **28/10/2024, ora 11.00.** pranë DPPI-së.*

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I KOMANDUAR

MARIA SOBIS

